



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministerstvo Kulture, Omladine i Sportit	
Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref. Nr. Doru Dertum Dore Ndonikumi Egypis Signature	213112019 29-05-2019
PRISHTINE, PRISTINA, PRISHTINA	

**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government**

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

I LIDHUR

NDËRMJET

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

DHE

KOMUNES SE SUHAREKËS

1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është hartimi dhe zbatimi i projektit “ **Kulla e Rame Bllacës** ” ne fshatin Bllace- Komuna e Suharekës , i cili do të zbatohet gjatë vitit 2019.

2. AUTORITETET

Qëllim i Memorandumit do të përmbushet nga:

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)
- Komuna e Suharekës

3. OBLIGIMET E PALËVE

3.1. OBLIGIMET E MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT (më tutje MKRS)

MKRS merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi, si në vijim:

- 3.1.Harton projektin dhe iniciacion procedurën e prokurimit për projektin “ Kulla e Rame Bllacës ” ne fshatin Bllace- Komuna e Suharekës ;
- 3.2. Bashkë financon zbatimin e projektit me mjetet financiare në vlerë prej 20,000.00 euro (Njëzetë mijë euro), sipas buxhetit të përcaktuar për vitin 2019, Kodi i projektit 18377 (ne buxhetin e MKRS-së);
- 3.3. Institucionet kompetente te trashëgimisë kulturore, vartës et MKRS-se, shqyrtojnë, vlerësojnë dhe japid pëlqimin për projekt te konservimit- restaurimit;
- 3.4..Emërimin e organeve mbikëqyrëse me sa vijon: Një përfaqësues nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, një nga Instituti i Kosovës për Mbrojtje te Monumenteve (IKMM) dhe një nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore ne Prizren (QRTK-Prizren).

4. Komuna e Suharekës

Komuna e Suharekës, merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi, si në vijim:

- 4.1.Bashkë financon projektin “ Kulla e Rame Bllacës ” ne fshatin Bllace -Komuna e Suharekës
- 4.2. Vlera financiare e bashkëfinancimit është 15,000.00 euro (Pesëmbëdhjetë mijë euro), sipas buxhetit te Komunës se Suharekës për vitin 2019;

4.3.Obligohet ti përmbahet në përpikëri projektit të hartuar dhe dorëzuar ne MKRS kurse për çdo ndryshim si rezultat i punëve në terren, obligohet të informoj dhe kërkoj miratim për ndryshimet në MKRS/DTK/IKMM;

4.4.Obligohet te caktoj organin mbikëqyrës te projektit; Një kopje te Vendimit për caktimin e organit mbikëqyrës ta dërgoj ne Departamentin e Trashëgimisë Kulturore- si njësi kërkuese;

4.5.Organi mbikëqyrës, duhet te komunikojë dhe bashkërendoj veprimet ne bashkëpunim te ngushte me organet mbikëqyrëse te emëruar nga MKRS sipas pikës 3.3 te këtij memorandumi;

5. OBLIGIMET E PËRBASHKËTA TË PALEVE

Palët marrin përsipër këto obligime te përbashkëta sa i përket qëllimit te këtij Memorandumi, si ne vijim:

5.1.Realizimin e projektit dhe përbushjen e objektivave si është përcaktuar ne Dokumentin e Politikave Programore te Departamentit te Trashëgimisë Kulturore për vitin 2019, buxhetin e MKRS-se dhe buxhetin e Komunës se Suharekës ;

5.2.Bashkepunojne gjate kohës se zbatimit te projektit dhe informojnë njëra tjetrën përmes organeve mbikëqyrëse, te përcaktuara ne këtë memorandum

5.3.Shpenzimin e buxhetit sipas miratimit paraprak dhe te përcaktuar për vitin 2019.

6. ZBATIMI

MKRS dhe institucionet vartëse te saj si dhe Komuna e Suharekës, përcjellin zbatimin e memorandumit dhe udhëzojnë për veprime qe duhet te ndërmerren ne përbushjen e obligimeve te përcaktuara ne këtë Memorandum.

7. MUNDËSIA E NDËRPRERJES SE MEMORANDUMIT DHE RRETHANAT E PA PARASHIKUARA

7.1.Ndërprerja e Memorandumit të Mirëkuptimit bëhet më marrëveshje ndërmjet palëve;

7.2.Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhive të Fuqisë mbinatyrore – Vis maior dhe rrethanave tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim ne palët tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmerren;

7.3.Afat i realizimit te qëllimit te këtij Memorandumi duhet te arrihet gjate vitit 2019.

7.4.Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshoj apo plotësohet sipas një Marrëveshje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë MM, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në MM në të ardhmen, apo në një amendament të këtij MM-je, të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshje do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

8. ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRVESHJEVE

Palët do të përpiqen qe mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjidh rastet e tillë.

9. KOPJET DHE GJUHËT E MEMORANDUMIT

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është përpiluar në katër (4) kopje origjinale. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

10. HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum Mirëkuptimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.



Bali Muharremi, Kryetar
Komuna e Suharekës
(Handwritten signature)
29-05-2019

